



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1256/10 prot.

Datë 20.05.2026

V E N D I M
Nr.680/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.599/2026, datë 07.05.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK me NIPT M51310002C dhe adresë: Rruga Sami Frasheri, Nd 23, H 10, Ap 21,1019, Njesia Nr 5, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë, me adresë: Blloku Nr.1 Lagja “Tafil Skendo”.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 07.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 599/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe vendimit të KSHA si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2022 prot., datë 13.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1256/7 prot., date 15.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë, njofton se ka bërë modifikimet lidhur me vendimin e sipërcituar, si dhe ka publikuar shtojcën e modifikuar, si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 2022 prot., datë 13.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1256/7 prot., date 15.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë, njofton se ka bërë modifikimet lidhur me vendimin e sipërcituar, si dhe ka publikuar shtojcën e modifikuar, si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi

II.2.Referua shkresës së sipërcituar si dhe nga verifikimi i sistemit elektronik SPE, rezulton se autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë, ka publikuar shtojcën e modifikuar.

II.3. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare ka zbatuar vendimin Nr. 599/2026, datë 07.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

